



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	13.03.2025
REFERENC-Ë:	24/2292/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Beni 1" Sh.p.k. Cërnillë, Ferizaj Ekspluatim i gurit gëlqeror, Cërnillë, Ferizaj
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Beni 1" Sh.p.k. Cërnillë, Ferizaj me Nr.Prot. 24/2292/MMPHI dhe ka vendosur si ne Vendim për Leje Mjedisore të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/2292/MMPHI
Datë: 13.03.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi, 1, 2 dhe 4 të nenit 12, neni 17, paragrafi 2 dhe neni 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1.Operatorit "Beni 1" Sh.p.k. Cërnillë, Ferizaj i vazhdohet Leja Mjedisore, për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, në ngastrat nr. P- 72209088-00708-0, në sipërfaqe prej 585m² zona kadastrale Cërnillë, Ferizaj.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku bëhet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;

- 2.3. T'i përmbahet kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror sipas përshkrimit në aplikacion;
- 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;
- 2.5. Vazhdimisht të bëhet spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara të cilat shfrytëzohen për bartjen e gurit gëlqeror;
- 2.6. Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kritereve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion;
- 2.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në.

A r s y e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin "Beni 1" Sh.p.k. Ferizaj për veprimtarinë: Eksploitim i gurit gëlqeror, në ngastrat nr. P-72209088-00705-0; P-72209088-00715-0 dhe P-72209088-00708-0, zona kadastrale Cërnillë, Ferizaj, MMPHI, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në terren konstaton se operatori i lartcekur, i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 17/1959/1-ZSP/ /17, data e lëshimit: 25.05.2017;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 17/3114/1-ZSP/181 /17, data e lëshimit: 14.07.2017;
- Leje Mjedisore, Nr.18/4395/ZSP/33/19, data e lëshimit: 25.01.2019;
- Licencë e Shfrytëzimit, 1716/KPMM/2017, Nr. prot.3610, data e lëshimit: 18.08.2017, me afat të vlefshmërisë deri me datë: 02.08.2029
- Pëlqim nga APK, Nr. ref. KE-648/22, data e lëshimit: 09.09.2022.
- Kontratë nga APK, Nr. ref. KE-692/22, data e lëshimit: 27.09.2022.

Andaj bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar nga pala dhe gjendjes faktike duke përfshi shikimin ne vend me zyrtaret profesional sipas legjislacionit ne fuqi për mjedisin dhe Udhëzimit Administrativ te MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si ne dispozitiv.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore ne dispozite është përcaktuar, në përputhje të nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Nr.24/2292/ZSP/ /25 datë: 11.03.2025

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi t'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
3. Komunës- Ferizaj;
4. DMMU-së;
5. Inspektoratit të MMPHI-së;
6. Kabinetit të Ministrit;
7. Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
8. Arkivit të MMPHI-së.